

**PROJEKT MARREVESHJE**

**PER : BASHKIMIN ME PERTHITHJE TE SHOQERIVE**

**“Imperial Group” sh.a dhe “Imperial C. Construction ” sh.p.k**

Tirane, me 02 Maj 2023

Shoqeria “Imperial Group” sh.a eshte regjistruar si person juridik prane Qendres Kombetare te Biznesit me daten 24/12/2010, me seli *Rruga Luigj Gurakuqi, Pallati Mig-Mar, Pallati 12 katesh , Kati 1, Nr.Pasurie 2/144-N2,Tirane.*

Shoqeria “Imperial Group” sh.a me NIPT-in L02424005D, aktualisht ka nje kapital themeltar prej 1,422,427,659 leke me kontribut 22 % te Ortakut Kolë Gjoka, 56 % Te Ortakut Pellumb Gjoka dhe 22 % te Ortakut Alida Gjoka. Administrator i shoqerise eshte Gentjan Haka.

Shoqeria “Imperial C. Construction” sh.p.k eshte regjistruar si person juridik prane Qendres Kombetare te Biznesit me daten 15/07/2016, me seli *Rruga "Jeronim De Rada", Nr 43, Nr pasurie 6/348+1-43, Zona Kadastrale 8150,Tirane.*

Shoqeria “Imperial C. Construction” sh.p.k me NIPT-in L61915015H, aktualisht ka nje kapital themeltar prej 100.000 leke me kontribut 100% te Ortakut te Vetem L61915015H. Administrator i shoqerise eshte Gentjan Haka.

Pas bisedimesh paraprake organet vendimarrese te dy shoqerive kane rene dakort per bashkimin e shoqerive, ne zbatim te ligjit 9901 date 14.04.2008 per “Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” te nenit 215 pika 1.

Ne zbatim te nenit 216 pika 1 te ligjit 9901 date 14.04.2008 per “Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” hartohet ky projek per bashkimi e shoqerive me keto kushte :

**1.Bashkimi** do te kryhet ne formen e perthithjes ku shoqeria tregtare “Imperial Group” sh.a do te jete shoqeria perthithese dhe shoqeria tregtare “Imperial C. Construction.” sh.p.k do te jete shoqeria e perthithur.

**2.Raporti kembimit te Kuotave** do te jete ne zbatim te ligjit 129/2014 date 02.10.2014 ne ndryshim te ligjit 9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” neni 68 pika 2 ku çdo ortak do te kete nje kuote, ndersa pjesemarrja ne kapitalin themeltar te shoqerise do te jete mbi bazen e vleres ne leke qe ze shumta e kapitalit themeltar te seciles shoqeri qe merr pjese ne procesin e perthithjes ndaj kapitalit themeltar te shoqerise se re pas perthithjes e rrjedhimisht dhe secili ortak ne raport me pjesemarrjen ne kapitalit themeltar te shoqerise qe merr pjese ne procesin e perthithjes e me pas me raportin e secilit ortak ne kapitalin themeltar te shoqerise se re pas perthithjes.

**3.Kushtet e ndarjes se kuotave** te shoqerise pas bashkimit me perthithje do te jete ne zbatim te ligjit 129/2014 date 02.10.2014 ne ndryshim te ligjit 9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” neni 68 pika 2 ku çdo ortak do te kete nje kuote, ndersa pjesemarrja ne kapitalin themeltar te shoqerise do jete mbi bazen e raportit qe ze secili kapital themeltar i shoqerive te veçanta ndaj totalit te kapitalit themeltar ne shoqerine e re.

J

4. **Data**, duke u nisur nga e cila zotëruesit e kuotave (ortaket e shoqërisë se re pas perthithjes) kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e fitimit do të jete 01.04.2023.
5. **Data**, duke nisur nga e cila veprimet e shoqërisë “Imperial C. Construction.” sh.p.k që përthithet do të trajtohen nga pikëpamja kontabël si veprime të shoqërisë përthithëse “Imperial Group” sh.a do të jete 01.04.2023.
6. **Të drejtat** që shoqëria përthithëse “Imperial Group” sh.a u njeh zotëruesve të kuotave (ortakeve), janë ato që percaktohen në statutin e shoqërisë përthithëse “Imperial Group” sh.a dhe në zbatim të ligjit 9901 date 14.04.2008 për “Tregetaret dhe Shoqërite Tregetare”.
7. **Perparesite** apo kufizimet e Administratorit të shoqërisë se re pas perthithjes do të jete ato që i njeh statuti i shoqërisë përthithëse “Imperial Group” sh.a. dhe në zbatim të ligjit 9901 date 14.04.2008 për “Tregetaret dhe Shoqërite Tregetare”.
8. **Pasojat** e bashkimit nuk do të kene asnje influence ndaj të punësuarve të të dyja shoqërive që marrin pjesë në procesin e perthithjes.
9. **Pasojat** e bashkimit nuk do të kene asnje influence ndaj të tretteve të sejciles shoqëri para perthithjes.
10. **Ortakët e shoqërisë** do të jete: 22 % të kapitalit Kolë Gjoka, 56 % të kapitalit Pellumb Gjoka dhe 22 % të kapitalit Alida Gjoka
11. **Emri i shoqërisë** se krijuar nga bashkimi do të jete “Imperial Group” sh.a
12. **Selia e shoqërisë** se re do të jete: *Rruga Lirij Gurakuqi, Pallati Mig-Mar, Pallati 12 katesh , Kati 1, Nr.Pasurie 2/144-N2*
13. **Statuti i shoqërisë** se re pas perthithjes do të jete ai i shoqërisë “Imperial Group” sh.a para perthithjes
14. **Objekti veprimtarisë i shoqërisë** se re pas perthithjes do të jete ai i shoqërisë “Imperial Group” sh.a para perthithjes
15. **Administratore e shoqërisë** se krijuar nga bashkimi do të jete Gentjan Haka me një mandat 5 vjeçar.
16. **Baza e nisjes** për bashkimin do të jete treguesit e bilancit të dates 31.03.2023, ndersa aktiviteti i vitit 2023 do të jete i perbashket me sistemit e nevojeshme sipas Standarteve Kombetare të Kontabilitetit të permiresuara në zbatim të ligjit 25/2018 dt. 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".
17. **Kapitali aksioner dhe Perqindjet** (te trajtuara në pikën 2 dhe 3 si më sipër) e secilit ortak në kapitalin e ri themeltar të krijuar nga bashkimi do të percaktohen pas paraqitjes së aktit të ekspertimit nga shoqëria Audituese "Erleva Gani Pf.
18. **Të drejtat dhe detyrimet** e shoqërisë “Imperial C. Construction.” sh.p.k do të kalojnë shoqërisë “Imperial Group” sh.a

Per Shoqërine “Imperial Group” sh.a

Per Shoqërine “Imperial C. Construction” sh.p.k

Perfaqesuesi Ligjor

*Gentjan Haka*



Perfaqesuesi Ligjor

*Gentjan Haka*

